

Standardet Kombetare te Kontabilitetit – Midis Kuptueshmerise dhe Zbatimit

Alban Xhelili KM

Kryetari i Deges se IKM-se Durres

Adresa: Lagja 3, Rruga Skenderbe – Durres

Cel: +355692091015 e-mail: studioxhelili@gmail.com

Ne kete punim eshte patur parasysh zbatimin ne praktike te ndryshimeve thelbesore qe kane ndodhur tek Standardet Kombetare Kontabel te Permiresuara ne raport me SKK-te. Me gjeresisht jane analizuar ndryshimet e ndodhura ne Standardet Kombetare Kontabel (me poshte thjesht SKK) te vecanta, ku vemendje me e madhe i eshte kushtuar atyre Standardeve te cilet jo vetem qe kane qene objekt i ndryshimeve me thelbesore por edhe atyre Standardeve te cilet kane nje shtrirje me te gjere pasi edhe problematikat ne lidhje me keto Standarde brenda njesive ekonomike eshte me e shpeshte.

Ne kete punim eshte bere nje pasqyrim i trajtimeve kontabel sipas SKK-ve dhe SKK-ve te permiresuara. Gjithashtu kane dale ne pah problematika te ndryshme qe lidhen me zbatimin ne praktike te cilat kane te bejne me faktore te ndryshem. Ne fund te ketij artikulli jepen konkluzione dhe rekomandime te cilat do te ndihmonin ne permiresimin e cilesise se hartimit te Pasqyrave Financiare duke u bazuar tek Standardet Kombetare te Kontabilitetit te Permiresuara.

Ky punim do te reflektoje ndryshime thelbesore te SKK-ve te permiresuara duke e perqendruar vemendjen ne problematikat e hasura gjate zbatimit te tyre ne praktike.

Fjalet kyçe: *Standardet Kombetare Kontabel te Permiresuara, Pasqyrat Financiare, Kuptueshmeria, Zbatimi dhe Raportimi Tatimor.*

1- Hyrje

Hartimi dhe vendosja për zbatim e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara erdhi si domosdoshmeri për t'iu përafuar dhe përshtatur sa më mirë Standardeve Nderkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF-te) dhe Direktives së Bashkimit Europian për Legjislacionin Shqiptar. Duke qenë se deri në vitin 2013 mbajtja e kontabilitetit trajtohej sipas Planit të Përgjithshëm Kontabel dhe Ligjit Nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”¹, të ndryshuar, hyrja e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit përmirësoi në mënyrë të ndjeshme në radhë të parë Kuadrin Konceptual bazë dhe në radhë të dytë bazat e vlerësimit dhe trajtimit të elementeve të ndryshme të Pasqyrave Financiare.

Me tej u gjykua që ishte i nevojshëm edhe një përmirësim për sa i përket Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit. Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit (me poshtë thjesht KKK) në datë 24/11/2012 mori Vendim për përmirësimin (rishikimin) e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit dhe më pas, me Urdhër të Ministrit të Financave Nr.64, datë 22/07/2014², u shpallën të detyrueshme për zbatim nga data 01/01/2015.

Ky përmirësim u paraqit si kërkesë e kohës duke parë një sërë problematikash të lindura gjatë zbatimit në praktikë për herë të parë që nga hyrja në fuqi, datë 01 Janar 2008, i Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara gjatë zbatimit të tyre në praktikë në vitin 2015 duket qartë që kanë sjellë një ndryshim cilësor në hartimin e Pasqyrave Financiare, pasi këto të fundit ofrojnë informacion më të përshtatshëm rreth Pasqyrës së Pozicionit Financiar, Pasqyrës së Performancës dhe Pasqyrës së flukseve të parasë të njesise ekonomike.

Ky përmirësim është i domosdoshëm për vendimmarrje ekonomike nga ai grup përdoruesish, të cilët nuk kanë mundësi që në formë të tjera të pajisen me informacionin e nevojshëm.

Në këtë punim janë trajtuar ndryshimet që kanë pesuar Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK 1-15) si dhe efektet e tyre mbi Pasqyrat Financiare. Me tej është vijuar me ndikimet që ka pasur legjislacioni taktimor në zbatimin e kërkesave të SKK-ve gjatë mbajtjes së kontabilitetit dhe hartimit të Pasqyrave Financiare për vitin 2015. Në fund jepen rekomandimet për problematikën që solli tranzicionin e kalimit nga SKK-te tek SKK-te e përmirësuara.

¹ Ligjit Nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”

² Urdhër i Ministrit të Financave Nr.64, datë 22/07/2014 “Për Shpalljen e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara dhe Zbatimin e Detyrueshëm të Tyre”

2- Ndryshimet e SKK-ve 1-15 dhe Raportimi Tatimor

2/1 Ndryshimet e SKK-ve 1-15

Ky punim është fokusuar në ndryshimet e ndodhura tek disa SKK, të cilat kanë një shtrirje më të gjërë në hartimin e Pasqyrave Financiare. Me poshtë paraqiten të detajuara ndryshimet që kanë ndodhur dhe ndikimi i tyre në Pasqyrat Financiare.

SKK 1 - Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e Pasqyrave Financiare

Objektivi i Pasqyrave Financiare është shtrirë jo vetëm tek të qenit i besueshëm por edhe tek dhënia e informacionit për Pasqyrën e pozicionit financiar, Pasqyrën e performancës dhe Pasqyrën e flukseve të parasë.

Në SKK1 është përcaktuar qartë koncepti i pritshmerisë që ka njësi ekonomike mbi një aktiv dhe njohja e tij fillestare me koston historike, duke mos marrë në konsideratë si element kryesor pronesinë mbi aktivin. Ky ndryshim i ka orientuar hartuesit e Pasqyrave Financiare drejt një vlerësimi më real, qoftë në lidhje me: të njohje ose jo një aktiv por edhe me ç'farë vlere duhet njohur ky aktiv.

Ndryshimi tjetër që ka pësuar ky standard është korigjimi i gabimeve në periudhat e kaluara të cilat nuk duhet të prekin fitim-humbjen aktuale, por të korigjohet në periudhën përkatëse nësoj sikur gabimi të mos kishte ndodhur kurrë.

Gjithashtu është futur koncepti i të ardhurave gjithëpërfshirëse për të mos i përfshirë keto në fitim-humbje.

SKK 2 - Paraqitja e Pasqyrave Financiare

Disa nga ndryshimet më thelbësore në këtë Standard kanë të bëjnë me terminologjinë e përdorur. Termi Bilanc është zëvendësuar me termin Pasqyra e Pozicionit Financiar, termi Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve është zëvendësuar me termin Pasqyra e Performancës Ekonomike e cila përfshin Fitim-Humbjen dhe Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse. Gjithashtu, termi Pasiv është zëvendësuar me termin Detyrim dhe Kapital.

Një ndryshim tjetër është edhe hartimi i Pasqyrave Financiare duke futur konceptin e monedhës funksionale, e cila është monedha e mjedisit primar ekonomik ose monedha me të cilën ndodhin transaksionet e njësisë ekonomike.

SKK 3 - Instrumentet Financiare

Aktivitet dhe detyrimet financiare mbahen vetem me kosto te amortizuar dhe jo me vleren e drejte. Ky eshte ndryshimi thellesor qe ka pesuar ky Standard, i cili eshte reflektuar edhe ne Pasqyrat Financiare te vitit 2015.

SKK 4 - Inventaret

Ne kete standard eshte bere rregullimi ne lidhje me produktet bujqesore para momentit te vjeljes dhe te matura me vleren e drejte pakesuar kjo me kostot e shitjes, duke i perfshire keta te fundit ne fushen e zbatimit te SKK 13, pasi trajtimi i meparshen krijonte probleme ne ndjekjen e ketyre aktiveve dhe paraqitjen e tyre ne Pasqyrat Financiare. Vetem pas momentit te vjeljes kemi te bejme me inventar i cili hyn ne fushen e zbatimit te ketij standardi.

Ne kete Standard eshte parashikuar edhe koncepti i riblerjes ku percaktohet se pagesa e inventareve do te kryet ne nje moment te dyte (ne kushtet e shlyerjes se shtyre) me çmim me te larte. Inventari i shitur klasifikohet si garanci per nje hua dhe jo si levizje inventari, nga ku diferenca e çmimit njihet si shpenzim financiar (interes).

Interesi i huase se mare per blerjen e inventare te cilet ne kushte te aftesise paguese do te mund te bliheshin me nje çmim me te ulet, nuk perfshihet ne koston e tyre por ne shpenzimet e periudhes gjate shlyerjes, duke eleminuar deformimet e mundshme ne koston e inventarit. Edhe pse ketu vlen te theksohet se ne praktike edhe ne te kaluaren eshte ndjekur kjo forme persa i perket interesit te huase. Natyrisht, ka patur nje devijim nga SKK 4 origjinal, por ka qene me e thjeshte per tu ndjekur. Persa i perket diferencës midis çmimit te blerjes me ane te nje huaje dhe atij qe mund te paguhej ne kushte te tjera, kjo nuk gjen zbatim ne mase per shkak edhe te percaktimit nga ana e organit tatimor lidhur me koston e mallrave.

Per inventaret si politike kontabel per paraqitjen e tyre ne Pasqyrat Financiare, duhet te ishte: inventari duhet te paraqitet me vleren me te ulet, midis koston dhe çmimit te shitjes minus koston e transaksionit te shitjes. Ne fakt asnjehere nuk eshte bere ky krahasim, por hartuesit e Pasqyrave Financiare paraqesin inventarin me koston historike te blerjes, duke zgjedhur metoden me te thjeshte per ta. Kjo nuk eshte mare ne konsiderate edhe per rastet kur ne vitin pasardhes ky inventar eshte shitur me humbje dhe pse ne momentin e hartimit te Pasqyrave Financiare ka patur informacion te mjaftueshem per renien e çmimeve te shitjes.

SKK 5 - Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale

Gjate permiresimit qe i eshte bere SKK 5, ka dale nga fusha e zbatimit te ketij standardi trajtimi i emrit te mire dhe perfshirja e tij tek SKK 13.

Perfshirja ne kete standard e Aktiveve Afatgjata Materiale (AAM) te investuara si toka, ndertesa ose pjese e saj nga te cilat perfitohen te ardhura si rezultat i nje kontrate qiraje ose vleresim kapitali me kusht qe te mos shiten, pasi duhet te klasifikoheshin si AAM te mbajtura per shitje. Percaktimi i qartesuar ne kete Standard lidhur me perkufizimin dhe njohjen ka bere qe te kemi pasur nje reflektim pozitiv dhe pasqyrim te vertete gjate hartimit te Pasqyrave Financiare te vitit 2015 duke paraqitur me vete çdo grupim te AAM-ve.

Gjithashtu ne kete Standard eshte parashikuar edhe rasti kur blihet ndertese bashke me token, kesaj here ne dallim nga trajtimi i meparshem keto do te trajtohen si dy AAM te ndara nga njera tjetra. Ky percaktim i SKK-se ka bere qe te kemi nje pasqyrim me te vertete si ne lidhje me vleren e AAM-ve ne Pasqyren e Pozicionit Financiar po ashtu edhe te amortizimit perkates ne Pasqyren e Performances.

Zakonisht pjeset e kembimit, instrumentat dhe veglat e punes mbahen si inventare. Ne rast se pjeset e kembimit, instrumentat dhe veglat e punes mund te perdoren per me shume se nje periudhe dhe vetem ne lidhje me nje ze te AAM, atehere keto konsiderohen si AAM me vete. Problemi qe hasej shpesh gjate hartimit te Pasqyrave Financiare ishte, perfshirja ose jo e tyre ne koston e aktivitetit. Percaktimi nese jeta e dobishme e tyre eshte ne menyre te konsiderueshme e ndryshme nga ajo e AAM ka bere qe te jete me i thjeshte pasqyrimi i drejte i ketyre aktiveve ne Pasqyrat Financiare te vitit 2015. Gjate permiresimit te ketij Standardi jane pershkruar sakte faktoret qe ndihmojne ne percaktimin e jetes se dobishme te nje AAM-je.

Interesat e huase ne versionin e permiresuar njihen si shpenzime periudhe ne dallim me versionin e kaluar ku keto interesa kapitalizoheshin.

Elementet perberes te nje AAM-je qe kane ne menyre te konsiderueshme jete te dobishme te ndryshme nga AAM-te, njihen dhe amortizohen me vete.

Eshte bere percaktim mbi token e minierave dhe token per groposje te cilat jane objekt amortizimi. Ky percaktim i Standardit ka hasur jo pak veshtiresi ne praktike pasi po ti referohemi legjislacionit tatimor, nuk ka nje percaktim te qarte per llogaritjen e amortizimit te tokes.

Persa i perket amortizimit te AAM-ve gjate procesit te prodhimit te inventareve, ky amortizim nuk do te njihet si amortizim periudhe, por si kosto e inventarit. Ne kete rast duke

patur parasysh qe gjate hartimit te Pasqyrave Financiare eshte perdorur amortizimi ne baze grupi, ne nje pjese te mire eshte anashkaluar kjo kerkese e Standardit dhe mund te themi qe nuk ka patur nje pamje te vertete te Pasqyrave Financiare te vitit 2015. (vetem ne ato raste kur nuk eshte zbatuar me korrektesi kjo kerkese e SKK 5)

Edhe pse ne Standard parashikohet qe te rishikohet si jeta e dobishme e AAM po ashtu edhe amortizimi, per shkak te nje sere faktoresh ka raste qe nuk zbatohet kjo kerkese e SKK 5. Gjithashtu shume rralle mund te jene bere rivleresime te asetëve, per me teper ka njesi ekonomike qe nuk kane bere asnjehere rivleresimin e AAM-ve, por perdorin nje metode me te thjeshte per ta dhe te gjithë keta pa perjashtim, si politike kontabel ne paraqitjen e AAM-ve ne Pasqyrat Financiare, kane perdorur modelin e koston (kosto minus amortizim i akumuluar), dhe shume rralle mund te kene perdorur modelin e rivleresimit te AAM-ve.

Pas nje sere percaktimesh te rendesishme lidhur me AAJM nje ndihmese ka dhene edhe percaktimi i jetes se dobishme te nje aktivi qe rrjedh nga te drejta kontraktuale apo ligjore. Ne kete rast ka qene e thjeshte gjate hartimit te pasqyrave financiare te vitit 2015 te percaktohej pjesa e shpenzimeve te amortizimit per periudhen aktuale. Ne rastet kur njesia ekonomike ka vleresuar qe jeta e dobishme eshte me e shkurter, atehere ka mare ne konsiderate kete te fundit ne perlllogaritjen e shpenzimeve te amortizimit. Ka patur edhe raste kur eshte perdorur percaktimi i jetes se dobishme nga 5 vjet sipas SKK 5 ne versionin original ne 10 vjet sipas versionit te permiresuar. Standardi parashikon se AAJM dhe AAM mund çregjistrohen nese nuk do te gjenerojne perfitime ekonomike ose dalin jashte perdorimit.

Ne lidhje me AAM dhe AAJM te mbajtura per shitje me shpesh eshte ndeshur fenomeni i trajtimit te tyre si AAM ose AAJM ne pozicionin normal (pra aktive afatgjata dhe jo afatshkurtra) edhe pse njesia ka qene ne perfundim te perpjekjeve per shitjen e mundshme te tyre brenda 12 muajve te ardhshem. Nje nga arsyet qe keto aktive nuk jane klasifikuar per shitje eshte, nderprerja e amortizimit ne momentin e kalimit per shitje edhe pse ato mund te vazhdojne te perdoren, pra faktikisht, te amortizohen, rimarrja e tyre tek AAM nese nuk realizohet shitja mund te ndikonte ne rezultatin fiskal te vitit te meparshem, pra nje shpenzim amortizimi me i ulet dhe nje fitim me i larte.

Vlersimi i AAM dhe AAJM, edhe pse ne SKK 5 e permiresuar jane percaktuar shume qarte burimet e informacionit, per kushtet e Shqiperise ndeshet ne veshtiresi si rezultat i mungeses se tregjeve per aktivet. Kostot e vleresimit jane nje tjetër element qe pengon vlersimin e ketyre aktiveve. Hartuesit e Pasqyrave Financiare preferojne te mbajne Aktivet

Afatgjata me vleren kontabel neto, shpesh here si rezultat i formimit te kufizuar profesional por ne disa raste edhe per mungese te evidencave te nevojshme.

Disa kontabiliste shpesh preferojne te evidentojne ngjarjet pasi ndodhin dhe jo te pasqyrojne nje ngjarje qe ka propabilitet te larte per te ndodhur.

SKK 9 Kombinimet e Bizneseve dhe Konsolidimi

Emri i mirë është diferenca pozitive mes koston së blerjes dhe vlerës së drejtë /vlerës kontabël para blerjes së aktiveve neto të blear dhe amortizohet per 10 vjet.

Ne kete Standard eshte percaktuar edhe rasti kur kemi patur shpenzime interesi huaje per financimin e instrumenteve te kapitalit. Keto nuk jane kosto qe kane lidhje te drejtperdrejte me kombinimin e bizneseve, por keto kosto jane perfshihen ne vleresimin fillestar te instrumenteve te kapitalit

SKK 10 Grantet dhe Forma te Tjera te Ndhimes

Ne kete SKK eshte percaktuar se granti njihet ne te ardhura me kushtin e performances. Pra granti perfitohet vetem nese jane plotesuar ne te shkuaren ose do te plotesohen ne te ardhmen kushtet e percaktuara ne lidhje me veprimtarine e shfrytezimit te njesise ekonomike. Ky permiresim ka bere qe te kemi nje informacion me te sakte ne lidhje me vleren e granteve ne Pasqyrat Financiare.

SKK 13 Aktivitet biologjike dhe Marrëveshjet konçesionare

Per aktivitet biologjike eshte percaktuar qe njesia ekonomike duhet ti vleresoje me vleren e drejte kur kjo e fundit percaktohet sakte dhe pa kosto ose ne te kundert duhet ti mase me modelin e koston. Gjithashtu jane percaktuar sakte edhe faktoret qe njesia ekonomike duhet te mare ne konsiderate per te percaktuar vleren e drejte te aktivitetit.

E reja e ketij standardi eshte edhe percaktimi i bere per mareveshjet koncesionare.

2/2 Raportimi Tatimor

Ne kete punim natyrshem lind pyetja “a ka ndikuar legjislacioni tatimor ne zbatimin e kerkesave te SKK-ve gjate mbajtjes se kontabilitetit dhe hartimit te Pasqyrave Financiare per vitin 2015?” Edhe pse aktualisht ka 8 vite qe nga data e hyrjes ne fuqi e Standardeve Kombetare te Kontabilitetit, ne praktikën shqiptare vazhdon të mbizotërojë orientimi i raportimit financiar për efekte tatimore.

Hartuesit e Pasqyrave Financiare shpeshhere zbatojnë rregullat tatimore për rregulla kontabël atje ku ato janë si alternativa të njëra-tjetrës dhe ndeshen raste kur nuk i zbatojnë rregullimet kontabël atje kur ato ndalohen totalisht nga rregullimet tatimore.

Për sa më sipër është e qartë se ka dallime midis raportimit financiar dhe atij tatimor. Ndaj u pa e arsyeshme të paraqiten në punim këto dallime për disa elementë të Pasqyrës së pozicionit financiar dhe Pasqyrës së performances.

Këto elemente u përzgjedhën pasi, nga studimet e kryera për to janë evidentuar shpesh dallime mes dy raportimeve. Gjithashtu këto ishin subjekt i trajtimit në legjislacionin tatimor në vite i ndryshëm nga trajtimi kontabël i tyre.

Një arsye tjetër qëndron edhe në faktin e të kuptuarit se si dhe sa mund të jetë ndikimi i legjislacionit tatimor në raportimin financiar sipas standardeve kombetare të kontabilitetit të përmiresuara.

Problem i rëndësishëm jo vetëm gjatë vitit 2015 por gjatë të tërë katër 8 (tete) viteve të zbatimit të SKK-ve është se nuk kemi patur asnjë monitorim shtetëror nga organet tatimore, nëse këto standarde janë zbatuar në mënyrë korrekte nga hartuesit e Pasqyrave Financiare apo jo. Në këtë drejtim nuk ka patur asnjë vërejtje nga organet tatimore, për hartimin e Pasqyrave Financiare, nëse janë apo jo në përputhje me SKK-te. Vetëm Ekspertët Kontabel të Rregjistruar, kanë dhënë mendime nëse janë zbatuar ose jo në mënyrë korrekte kërkesat e SKK-ve. Në shumë raste këto opinione kanë ndikuar direkt në përmirësimin e zbatimit të SKK-ve nga kontabilistët. Do të ishte më mirë, nëse do të ishte një organizim i veçantë monitorimi, për zbatimin e SKK-ve.

Gjatë hartimit të Pasqyrave Financiare shpesh jemi hasur me pyetjen, nëse lejohet kompensimi në Pasqyrat Financiare të zerave "Kliente" me zera "Furnitore" për ato raste kur njësitë ekonomike kanë një marrëveshje ligjore për shuarjen e detyrimeve mes tyre jo nëpërmjet mjeteve monetare.

Në këtë rast është gjykuar që nuk jemi në kushtet e kompensimit të mirëfillte por në kushtet e SKK 1 të përmirësuar (paragrafi 15 dhe 23).

Njësia ekonomike mund të marrë përfitime ekonomike nga aktivi në disa forma. Një aktiv mund të: (a) përdoret më vetë ose i kombinuar me aktive të tjera për prodhimin e mallrave ose shërbimeve që shiten nga njësia ekonomike; (b) shkëmbehet me aktive të tjera; (c) përdoret për të shlyer/paguar një detyrim; (d) shpërndahet tek pronarët e njësisë ekonomike (paragrafi 15).

Detyrimi njihet në pasqyrën e pozicionit financiar, nëse njësia ekonomike, për të bërë shlyerjen e tij, do t'i duhet të veprojë në një mënyrë të tillë që do të shkaktonte dalje të

përfitimeve ekonomike. Për shlyerjen e detyrimit, njësisë ekonomike mund t'i duhet, për shembull, të paguajë me parà ose ekuivalente të saj, të ofrojë një shërbim të caktuar, të japë një aktiv të caktuar, ta zëvendësojë atë detyrim me një detyrim tjetër ose ta shndërrojë detyrimin në kapital (paragrafi 23).

Pra dhenia e një aktivi tek një njësi tjetër ekonomike në këtë rast shërben për shlyerjen e detyrimit (respektivisht për secilin pale) dhe sa me sipër nuk kërkon një kompensim në Pasqyrat Financiare të fund vitit, por njohje të transaksioneve të shlyerjeve sapo ngjarja ndodh. Ndonese përcaktimi referuar SKK-ve është shumë i qartë, njësitë ekonomike kanë hasur vështirësi në interpretimin që organi tatimor i jep shlyerjes së detyrimit.

Edhe pse këtu në këtë Standard shihet qartë se shlyerja e një detyrimi mund të kryet nëpërmjet dhenies së një shërbimi, një aktivi etj, njësitë ekonomike për të mos patur probleme me organin tatimor shpesh here janë detyruar që të kryejnë pagesa dhe arkitime fiktive të detyrimeve dhe të drejtave. Nëse ka qenë i pamundur ky veprim, atëherë njësitë ekonomike i kanë paraqitur këto të drejta dhe detyrime në Pasqyrat Financiare të vitit 2015. Kjo ka bërë që të mos zbatohet me korektesi objekti i SKK 1.

3- Konkluzionet dhe Rekomandimet

Zbatimi i Standardeve Kombetare te Kontabilitetit te Permiresuara paraqiti jo pak problematika gjate pergatitjes se Pasqyrave Financiare. Nje pjesë tjetër e njësive ekonomike me sensibilitet të konsiderueshëm lidhur me rëndësinë e zbatimit të SKK-ve te permiresuara dhe detyrimit ligjor për të bërë një gjë të tillë pati vështirësi dhe probleme që kishin të bënin me:

- Problemet e tranzicionit, të kalimit nga SKK-te tek SKK-te e permiresuara Keto kane te bejne me trajtimin e elementëve të pasqyres se Pozicionit Financiar paraardhës, të cilat paten një trajtim të ri kontabël në periudhen pasardhëse.

- Mungesa ne informacion lidhur me SKK-te e permiresuara nga ana e hartuesve te Pasqyrave Financiare

Hartuesit e PF preferojne te mbajne aktivet me vleren kontabel neto, shpesh here si rezultat i formimit te kufizuar profesional por ne disa raste edhe per mungese te evidencave te nevojshme. Disa kontabiliste shpesh preferojne te evidentojne ngjarjet pasi ndodhin dhe jo te pasqyrojne nje ngjarje qe ka probabilitet te larte per te ndodhur.

- Matjen, vlerësimin dhe paraqitjen e elementëve të Pasqyrave Financiare;

Vlersimi i AAM dhe AAJM, edhe pse ne SKK 5 e permiresuar jane percaktuar shume qarte burimet e informacionit, per kushtet e Shqiperise has ne veshtiresi si rezultat i mungeses se tregjeve per aktivet. Kostot e vleresimit jane nje tjetër element qe pengon vlersimin e ketyre aktiveve.

- Pasqyrat e reja financiare

Pasqyrat e reja financiare të cilat ndryshojnë nga ato të mëparshme krijuan në radhë të parë probleme lidhur me anën formale të hartimit të tyre. Tradita e paraqitjes së informacionit në një mënyrë të caktuar krijoi problemet e përshtatjes.

4-Bibliografia

1. Ligji Nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”
2. Urdher i Ministrit të Financave Nr.64, Date 22/07/2014 “Per Shpalljen e Standardeve Kombetare te Kontabilitetit te Permiresuara dhe Zbatimin e Detyrueshem te Tyre”
3. Standardet Kombetare te Kontabilitetit 1-15
4. Standardet Kombetare te Kontabilitetit te Permiresuara 1-15